

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK



Ass.Msc.Edona Perjuci

**ZBATUESHMËRIA E STANDARDEVE
NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR (SNRF) DHE EFEKTET E
TYRE NË KOSTON E KAPITALIT
HUAMARRËS TË NDËRMARRJEVE:
RASTI I KOSOVËS**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2019

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF ECONOMICS



Ass.Msc.Edona Perjuci

**“IMPLEMENTATION OF INTERNATIONAL
FINANCIAL REPORTING STANDARDS(IFRS)
AND THEIR IMPACT ON FIRM`S COST OF
DEBT: THE CASE OF KOSOVO**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2019

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK



Ass.Msc.Edona Perjuci

**ZBATUESHMËRIA E STANDARDEVE
NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR (SNRF) DHE EFEKTET E
TYRE NË KOSTON E KAPITALIT
HUAMARRËS TË NDËRMARRJEVE:
RASTI I KOSOVËS**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:

Prof.Dr. Hysen Ismajli

Prishtinë, 2019

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij studimi është që të analizohet në mënyrë empirike zbatueshmëria e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) tek ndërmarrjet në Kosovë, të cilat janë të obliguara ligjërisht që të raportojnë me këto standarde. Zbatueshmëria e këtyre standardeve është matur përmes ndikimit të tyre në performancën dhe pozicionin financiar të ndërmarrjeve subjekte të analizës, nivelin e përputhshmërisë së pasqyrave financiare me këto standarde, si dhe kostot dhe përfitimet nga implementimi i SNRF-ve.

Hulumtimi nuk fokusohet vetëm në këtë pjesë, por përpos kësaj studion edhe mënyrën se si zbatueshmëria e këtyre Standardeve ndikon në koston e huamarrjes të ndërmarrjeve në Kosovë, duke e analizuar koston e borxhit ose leverazhit financiar në mungesë të tregut të kapitalit për të analizuar edhe efektet në koston e ekuitetit. Si rezultat, shumë pak dihet për ndikimin e zbatimit të SNRF-ve në koston e borxhit. Për të mbushur këtë boshllëk sidomos për ekonomitë në tranzicion siç është Kosova, ky disertacion i doktoratës synon të ofrojë dëshmi sistematike në këtë çështje e cila mjaft pak është studiuar. Pra, qëllimi i kësaj pjese të hulumtimit është të vërtëtohet nëse ndërmarrjet pasqyrat financiare të të cilave janë të raportuara me SNRF-të dhe të audituara, kanë lehtësira në qasjen ndaj kapitalit, reduktim të koston së kapitalit dhe kushte më të favorshme jo financiare në marrjen e kredive.

Në pjesën e parë të hulumtimit janë analizuar pozicioni dhe performanca financiare e 100 ndërmarrjeve të mëdha si mostër e hulumtimit në Kosovë, duke e krahasuar performancën dhe pozicionin financiar për vitet para implementimit të SNRF-ve (vitet 2010-2012) dhe pas implementimit të SNRF-ve (vitet 2013-2017). Përmes analizës së zërave në pasqyrat financiare është përgatitur analiza e regresionit të shumëfishtë, duke caktuar faktorët matës të performancës dhe pozicionit financiar, si variabla të hulumtimit. Pra, variablat e hulumtimit në këtë pjesë janë: Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA), Kthimi në ekuitet (KNE), Marzha e fitimit neto, Kthimi i pasurisë, Koeficienti i borxhit, Hyrja në borxh/leverazhi, Koeficienti i ekuitetit ndaj pasurive, Mbulimi i interesit, Koeficienti i qarkullimit, Koeficienti i shpejtësisë ose Acid testi, Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme dhe Periudha e qarkullimit të stoqeve.

Në pjesën e dytë të hulumtimit të dhënat janë grumbulluar nga pyetëtorët të cilët i janë dërguar bankave dhe ofruesve të kapitalit (35 respondentë nga 8 banka) si dhe 100 kompanive (97 respondentë) të cilat kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi. Përmes analizës së përgjigjeve të marra dhe përmes analizës së variancave ANOVA janë vërtetuar hipotezat duke gjetur statistikat përshkruese dhe testin F statistikor.

Rezultatet tregojnë se SNRF-të kanë ndikuar në mënyrë signifikante në performancën dhe pozicionin financiar të ndërmarrjeve në Kosovë. Gjithashtu arrihet në përfundim se përfitimet tejkalojnë kostot nga implementimi i SNRF-ve dhe ndër përfitimet rangohen: i) rritja e krahasueshmërisë së pasqyrave financiare, ii) besimi më i madh në informacionin, iii) përfitime neto afatgjata për Kosovën, iv) përfitime neto afatgjata për kompaninë, v) përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar, vi) përmirësimi i partneriteteve me kompanitë e huaja, vii) zvogëlimi i kohës dhe kostos për konsoliduar pasqyrat financiare dhe si përfitimi i fundit konkludohet viii) largimi i barrierave për fluksin e kapitalit ndërkombëtar.

Gjithashtu është analizuar nëse pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të analizuara si mostër, janë në përputhje të plotë me kërkesat e SNRF-ve dhe janë gjetur fushat e mospërputhjes me kërkesat e SNRF-ve, si në vijim: *SNK 12- Tatimi në fitim, Standardet për instrumentet financiare, SNK 19 - Përfitimet e punonjësve, SNRF 16 – Lizingu, etj.*

Rezultatet nga analiza ANOVA nga pikëpamja e sektorit bankar dhe sektorit privat, tregojnë se adoptimi dhe implementimi i SNRF-ve në Kosovë ka ndikim signifikant në normat e interesit, të ofruara nga bankat tek adoptuesit e detyrueshëm si dhe në kushtet jofinanciare të kredive si: afatet kohore, hipotekat, shpenzime administrative më të ulëta, rinegocimin e kushteve të kredisë. Përdoruesit e detyrueshëm të SNRF-ve kanë një vlerësim më të mirë të kredisë krahasuar me kompanitë tjera në Kosovë dhe përqindja e kredive jo performuese (kreditë e këqija) është më e ulët për përdoruesit e detyrueshëm të SNRF-ve në Kosovë.

Gjetjet janë konsistente me hulumtimet paraprake të cilat gjejnë se adoptimi dhe implementimi i SNRF-ve ndikon në koeficientë më të lartë të performancës, cilësi më të mirë të raportimit financiar, efikasitet më të madh në kontraktimin e borxhit dhe si rezultat edhe kosto më të ulët të kapitalit huamarrës.

Fjalët kyçe: Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar (SNK dhe SNRF); pasqyrat financiare; kosto e kapitalit huamarrës; shpalosjet; transparenca dhe llogaridhënia.

ABSTRACT

The purpose of this study is to empirically analyze the implementation of International Financial Reporting Standards (IFRS) for companies in Kosovo, which are legally obliged to report in compliance with these standards. The implementation of these standards is measured by their impact on the key performance and financial position ratios of the companies, subject to the research, as well as the level of compliance of the financial statements with these standards, and the costs and benefits from the implementation of IFRSs in Kosovo.

The research does not focus solely on this part, but it also studies how the implementation of these standards affects the borrowing cost of companies in Kosovo, by analyzing the cost of debt or financial leverage in the absence of a capital market to analyze the effects on the cost of equity. As a result, little is known about the impact of the implementation of IFRSs on the cost of debt. To fill this gap, especially for transition economies such as Kosovo, this doctoral dissertation aims to provide systematic evidence on this issue, which has been studied quite a bit. Therefore, the purpose of this part of the research is to verify whether companies whose financial statements are audited and are in compliance with IFRSs have reduction in their cost of capital and more favorable non-financial conditions of loans.

In the first part of the research, the position and financial performance of 100 large enterprises in Kosovo were analyzed, comparing the performance and financial position for years before the implementation of IFRSs (2010-2012) and after the implementation of IFRS (2013-2017). Through the analysis of the items in the financial statements, a multiple regression analysis was prepared, specifying the performance and financial position ratios as the research variables. The research variables in this section are: Return on capital employed (ROCE), Return on equity (ROE), Profit margin, Asset turnover, Debt ratio, capital gearing ratio, Interest cover, Current ratio, quick ratio (Acid Test), Accounts receivable collection period, Inventory turnover period.

In the second part of the research data were collected from questionnaires sent to banks and capital providers (35 respondents from 8 banks) and 100 companies (97 respondents) who were part of this survey. Through the analysis of the answers received and through ANOVA variance analysis, hypotheses were tested through calculation of descriptive statistics and statistical F test.

The results show that IFRSs have significantly influenced the financial performance and position of enterprises in Kosovo. It is also concluded that the benefits outweigh the costs of implementing IFRSs and among the benefits are ranked: i) increasing the comparability of financial statements, ii) greater trust in information provided, iii) long term net benefits for Kosovo, iv) long-term net benefits for companies, v) improving the quality of financial reporting, vi) improving partnerships with foreign companies, vii) reducing time and cost for consolidating financial statements, and ultimately; viii) removing barriers for the international capital flow.

It was also analyzed whether the financial statements of the companies analyzed as a sample are in full compliance with the requirements of IFRSs and there were found the areas of non-compliance with those requirements, which are as follows: IAS 12- Profit Tax, Standards for financial instruments, IAS 19 - Employee Benefits, IFRS 16 - Leases, etc.

The results from the ANOVA analysis from the banking and private sector viewpoint show that the adoption and implementation of IFRSs in Kosovo has a significant impact on the interest rates offered by banks to mandatory IFRS adopters, as well as in non-financial loan terms such as: loan time limits, mortgage requirements, lower administrative costs and renegotiating loan terms. Mandatory IFRS adopters have a better loan rating compared to other companies in Kosovo and the percentage of non performing loans is lower for mandatory IFRS adopters in Kosovo.

The findings are consistent with the preliminary research that finds that the adoption and implementation of IFRSs impacts higher financial performance coefficients, better financial reporting quality, greater efficiency in debt contracting and as a result also a lower cost of the debt.

Keywords: International Accounting and Financial Reporting Standards (IAS and IFRS); financial statements; cost of borrowings; loan terms; disclosures; transparency and accountability.